

COVID-19

MASA TË PËRGJITHSHME PARANDALUESE

Rishikuar më 19.02.2021

ESEM | CPT

ENTE UNIFICATO FORMAZIONE E SICUREZZA

Organismo Bilaterale Paritetico costituito da Assimpredi ANCE e Feneal UIL,
Ficca CISL, Fillea CGIL per le province di Milano Lodi Monza e Brianza

Sistema Socio Sanitario




Regione
Lombardia

ATS Milano
Città Metropolitana

MASA TË PËRGJITHSHME PARANDALUESE

UDHËZUES I SHKURTËR PËR RINISJEN E PUNËS NË NDËRMARRJET JO SANITARE
OSE SOCIO-SANITARE GJATË URGJENCËS COVID-19



mbi udhëzimet e protokollit të përbashkët që rregullon masat për të luftuar dhe frenuar përhapjen e virusit Covid-19 në vendin e punës e datës 24.4.2020 dhe qarkoret e Ministrisë së Shëndetësisë

- ◇ INFORMACION I PËRGJITHSHËM
- ◇ MËNYRA E HYRJES NË KOMPANI
- ◇ HYRJA NË KOMPANI E FURNIZUESVE TË JASHTËM
- ◇ PASTRIMI/DEZINFEKTIMI I MJEDISEVE TË PUNËS
- ◇ MASAT PARAPRAKE TË HIGJENËS PERSONALE
- ◇ PAJISJE MBROJTËSE PERSONALE
- ◇ MENAXHIMI I HAPËSIRAVE TË PËRBASHKËTA
- ◇ MBIKËQYRJE SHËNDETËSORE DHE MJEK KOMPETENT
- ◇ KRYERJA E TESTEVE SEROLOGJIKE DHE TESTEVE ANTIGJENIKE TË SHPEJTA

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Veprimtaritë ekonomike dhe prodhuese duhet të kryhen në përputhje me protokollet dhe udhëzimet e përbashkëta, të miratuara nga Konferenca e Rajoneve dhe Provincave Autonome, të aktualizuara më 8 tetor 2020, bashkëlidhur Dekretit Ministror të datës 14 janar 2021. Të gjithë punëtorët duhet të informohem për masat paraprake të ndërmarra nga ndërmarja përmes shpërndarjes së broshurave ose me afishimin e posterave:



- ◇ Qëndroni në shtëpi nëse keni simptoma të gripit ose temperaturë më të lartë se 37.5°C dhe telefononi mjekun tuaj të kujdesit parësor.
- ◇ detyrimi në të gjithë territorin kombëtar për të pasur gjithmonë me vete pajisje mbrojtëse të frymëmarrjes, si dhe detyrimin për mbajtur ato në vende të mbyllura përveç shtëpive private dhe në të gjitha ambientet e jashtme, përveç në rastet kur, për shkak të karakteristikave të vendeve ose për shkak të rrethanave faktike, gjendja e izolimit nga personat jo-bashkëjetues është e garantuar vazhdimisht, (Dekreti Ministror 14 janar 2021, neni 1)
- ◇ Respektoni të gjitha dispozitat e kompanisë, gjithashtu në bazë të detyrave, si dhe kontekstit (përdorimi i maskave/PMP, rregullat e higjienës, distancat e sigurisë, komunikimin e simptomave në rritje të gripit, përdorimi i dhomave të përbashkëta, etj.).
- ◇ Takimet ballë për ballë dhe aktivitetet e trajnimit, nëse është e nevojshme, duhet të kryhen në përputhje me Dekretin Ministror të përmendur dhe udhëzimet specifike.
- ◇ Është e mundur që arrihet në ri-modulim të niveleve të prodhimit, punë me turne të stafit, favorizim të punës inteligjente.



MËNYRA E HYRJES NË KOMPANI

- ◇ Ndalimi i hyrjes në kompani në rast të kontakteve me njerëz pozitivë me Covid-19 në 14 ditët e mëparshme ose nëse ata vijnë nga zona që konsiderohet se janë në rrezik.
- ◇ ndalim të hyrjes në kompani me temperaturë mbi 37.5°C.
- ◇ nëse simptomat e sëmundjes shfaqen në kompani (ethe, dhimbje fyti, etj.) menjëherë duhet t'i komunikohet punëdhënësit ose menaxherit të tij dhe të qëndrohet larg nga njerëzit e tjerë të pranishëm. Vendosni maskën kirurgjike, izolohuni në një vend të përshtatshëm, kthehuni në shtëpi dhe kontaktoni mjekun tuaj të përgjithshëm

- ◇ hyrja në ndërmarrjen e punëtorëve të cilët tashmë kanë rezultuar pozitivë me infektionin Covid-19 dhe janë të shtruar në spital duhet të paraprihet me një vizitë paraprake nga mjeku kompetent.

Menaxhimi i hyrjes dhe daljes së punonjësve:

- ◇ masa të vendosura për të shmangur tubimet
- ◇ Orari i hyrjes dhe daljes me faza për të minimizuar kontaktet në zonat e përbashkëta



HYRJA E FURNIZUESVE TË JASHTËM

- ◇ Ata duhet të qëndrojnë sa më shumë të jetë e mundur brenda automjeteve të tyre dhe nuk duhet të hyjnë në zyra.
- ◇ Aktivitetet e nevojshme për ngarkim dhe shkarkim duhet të kryhen sipas procedurave të përcaktuara më parë.
- ◇ Rugët e përvijuara duhet të ndiqen për të zvogëluar mundësitë për kontakt me stafin e pranishëm nëpër departamente
- ◇ Në rast të ndërhyrjeve në aktivitet, transportuesi duhet t'i përmbahet distancës së rreptë prej një metër dhe mbajtjes së një maske kirurgjikale
- ◇ Tualete të dedikuara që nuk përdoren nga punonjësit, duke siguruar pastrim të mirë të përditshëm.
- ◇ Ulni mundësinë e hyrjes të vizitorëve dhe nëse është e nevojshme (aktivitete të pastrimit, mirëmbajtja) zbatoni rregullat e kompanisë ndaj tyre. Çdo dispozitë e këtij protokollit zbatohet për kompanitë kontraktuese.

PASTRIMI/DEZINFEKTIMI I MJEDISEVE TË PUNËS

- ◇ Është thelbësore të sigurohet pastrimi i përditshëm dhe dezinfektimi periodik i dhomave, mjediseve, vendeve të punës, zonave të përbashkëta dhe argëtimit.
- ◇ b. Nëpër zyra dhe departamente me përdorim të përzier të mobilieve dhe pajisjeve, në përfundim të turnit, siguroni pastrimin dhe dezinfektimin e të gjitha sipërfaqeve dhe pajisjeve të pranishme me mjete të përshtatshme (hipoklorit natriumi 0,1% ose 70% etanol) dhe vendosjen e masave të përshtatshme të mbrojtjes individuale (shiko Raporti ISS nr. 19 e datës 13 korrik 2020).
- ◇ Siguroni dezinfektimin periodik dhe pastrimin e përditshëm të ambienteve të mensës



- ◇ Nëse brenda ambienteve të ndërmarrjes konstatohet prania e një personi me Covid-19, procedoni me pastrimin dhe dezinfektimin, si dhe ajrosjen, sipas parashikimeve të qarkores nr. 5443 e datës 22 shkurt 2020 dhe nr. 17644 të datës 22/05/2020 dhe rekomandimet e raporteve ISS nr. 25 të datës 15 maj 2020, nr. 20 të datës 7 korrik 2020 dhe 56 të datës 23 korrik 2020
- ◇ Është e mundur të organizohen ndërhyrje speciale dhe periodike të pastrimit, duke përdorur rrjeta të sigurisë sociale, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe në mënyrën që konsiderohet më e përshtatshme.
- ◇ Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet pastrimit të sistemeve të ventilimit dhe ajrit të kondicionuar që ndodhet në dhomat e punës. (shiko raportet ISS nr. 5 të datës 25 maj 2020 dhe nr. 33 të datës 25 maj 2020)

Sistemet mekanike të kontrolluara të ventilimit (VCM) që ndodhen në ndërtesa duhet të qëndrojnë gjithmonë aktive, duke eliminuar plotësisht funksionin e riciklimit të ajrit, ato duhet të pastrohen çdo javë sipas udhëzimeve të prodhuesit, me vëmendje të veçantë për paketat e filtrit, të zëvendësohen nëse është e nevojshme me të tjera me efikasitet më të madh. Rrjetat dhe grilat e ventilimit duhet të pastrohen me sapun dhe ujë ose me një sulucion me të paktën 70% alkool etilik duke i tharë më pas.

Në rastin e sistemeve që kanë pajisje terminale lokale (spirale ftohëse ose kaloriferë) ose njësi të brendshme të llojit të ndarë apo kondicioner të lëvizshëm, nëse nuk është e mundur të mbahen të palëvizshëm, në dhomat e ndara nga disa njerëz, është e nevojshme të vazhdohet me pastrimin e përjavshëm të filtrave të ajrit riciklues, sipas udhëzimeve të prodhuesit



MASAT PARAPRAKE TË HIGJENËS PERSONALE

- ◇ Lani duart tuaja tërësisht dhe shpesh.
- ◇ Vendosni pastruesit me lëng detergjent për larjen e duarve në dispozicion për punonjësit.
- ◇ Vini në dispozicion të punonjësve pajisjet për dezinfektimin e duarve (xhel hidro-alkoolik) në vende lehtësisht të identifikueshme

PAJISJE MBROJTËSE PERSONALE

- ◊ PMP e përshtatshme miratohen bazuar në vlerësimin e rreziqeve të përgjithshme dhe hartës së aktiviteteve të ndryshme të kompanisë.
- ◊ PMP anti-ngjitëse janë të detyrueshme në vende të mbyllura të arritshme nga publiku, duke përfshirë mjetet e transportit edhe kur punoni në një distancë ndërpersonale më të vogël se një metër dhe zgjidhjet e tjera organizative nuk janë të mundshme. Për këtë qëllim, lejohet përdorimi i maskave kirurgjikale. Urdhri i rajonit të Lombardisë me nr. 604 i datës 10 shtator 2020 përcakton detyrimin për të përdorur maska, pavarësisht nga vendi ku kryhet aktiviteti, për personelin që punon në aktivitete ekonomike, produktive dhe sociale. Karakteristikat e PMP specifikohen vetëm për aktivitetet sanitare dhe socio-sanitare (treguar në Raportin ISS Covid-19 nr. 2/2020 aktualizuar më 10/05/2020.



MENAXHIMI I HAPËSIRAVE TË PËRBASHKËTA

- ◊ Duhet të zbatohen dispozitat e përcaktuara për të luftuar përhapjen e virusit Covid-19 në çdo zonë e përbashkët në kompani.
- ◊ Qasja në grupe në të gjitha zonat e përbashkëta duhet të jetë e shoqëruar me ajrosje të vazhdueshme të ambienteve, një kohë pushimi të reduktuar dhe mirëmbajtje të distancës prej një metri midis njerëzve të pranishëm.
- ◊ Siguroni organizimin e hapësirave dhe dezinfektimin e dhomave të ndërrimit duke siguruar kushte të përshtatshme higjeno-sanitare.
- ◊ Siguroni dezinfektimin periodik dhe pastrimin e përditshëm të ambienteve të mensës, makinerive të pijeve dhe ushqimeve të lehta, etj.

MBIKËQYRJE SHËNDETËSORE DHE MJEK KOMPETENT

Qarkore nga Ministria e Shëndetësisë e datës 29/04/2020: roli i mjekut kompetent në menaxhimin e rrezikut dhe rastet e Covid-19; Qarkorja ndërministrorë 13 e datës 4 shtator 20: aktualizime dhe sqarime, veçanërisht në lidhje me punëtorët "e prekshëm";



Qarkorja INAIL me nr. 13 e datës 03/04/2020 dhe nr. 22 e datës 20/05/2020: parandalimi i aksidenteve të rasteve të konfirmuara të infeksionit koronavirus (SARS-COV-2); Qarkoret dhe urdhrat e rajonit të Lombardisë

- ◊ Kompania duhet të privilegjojë vizitat parandaluese, vizitat sipas kërkesës dhe vizitat për kthimin nga sëmundja.

- ◇ Mjeku kompetent duhet të sigurojë informacione për punonjësit në mënyrë që të luftojë përhapjen e infeksionit.
- ◇ Mjeku kompetent bashkëpunon me punëdhënësin, drejtuesin e shërbimit të parandalimit dhe sigurisë, me përfaqësuesin e punonjësve.
- ◇ Punëtorët mund të kërkojnë nga punëdhënësi që ti vizitojë mjeku kompetent në rastet e patologjive me pak kompensim klinik, për vlerësim të kushteve të prekshmërisë. Në rezultatin e vlerësimit, mjeku kompetent shpreh gjykimin e përshtatshmërisë duke dhënë indikacione të një kujdesi më të madh për rrezikun nga Covid19 dhe bashkëpunon me punëdhënësin, i cili miraton masat, të vendosura ndoshta në komision, të nevojshme për të mbrojtur punëtorin, që nuk mund të pushohet nga puna.
- ◇ Mjeku kompetent mund të sugjerojë miratimin e çdo mjeti diagnostikues nëse vlerësohet i dobishëm në mënyrë që të frenojë përhapjen e virusit.
- ◇ Pas kthimit në punë pas sëmundjes për Covid-19 i cili kërkoi shtrimin në spital, me paraqitjen e certifikatës "rast negativ", bëhet një ekzaminim mjekësor



TRAJTIMI I NJË PERSONI SIMPTOMATIK NË NJË KOMPANI JO SANITARE OSE SOCIO-SANITARE

- ◇ Nëse një punonjës i pranishëm në kompani zhvillon simptoma të ngjashme me gripin (kollë, dhimbje të fytit, ethe, etj.), menjëherë duhet t'ia komunikojë personit referues të identifikuar nga punëdhënësi për administrimin e urgjencës Covid-19.
- ◇ Vazhdohet me izolimin e personit simptomatik në një dhomë të dedikuar, duke i siguruar atij doreza dhe maskë kirurgjikale dhe duke e ftuar atë të shkojë në shtëpinë e tij dhe të kontaktojë menjëherë mjekun e tij.
- ◇ Kompania njofton ATS-në kompetente për zonën përmes mjekut kompetent. Nëse mjeku kompetent nuk është i arritshëm ose nuk është caktuar, komunikimi me ATS-në do të bëhet nga mjeku me të cilin punonjësi merr përsipër të kontaktojë, duke nënshkruar një deklaratë specifike të përgatitur nga kompania (shiko fundin e udhëzuesit).
- ◇ Kompanisë i bëhet thirrje të bashkëpunojë me Autoritetet e Shëndetit, përmes personit të mjekut kompetent, për përcaktimin dhe menaxhimin e rasteve të dyshuara Covid-19 dhe çdo kontakti të ngushtë. Rajoni i Lombardisë, me rezolutën 3114, të datës 7 maj 2020, përfshin një rrjet të gjerë mjekësh në mbikëqyrje aktive, përfshirë mjekët kompetentë, me qëllim identifikimin dhe izolimin e shpejtë të rasteve të dyshuara dhe kontaktet e tyre të ngushta. Pra, përfshirja e punëdhënësve nuk kufizohet në aspektet e rregulluara dhe të lidhura me procedurat e kontrollit të temperaturës për hyrjen në vendin e punës, por parashikon raportim të menjëhershëm të rasteve të dyshuara dhe kontakteve të tyre të ngushta. Në mënyrë të veçantë, për të kapur menjëherë rastet e mundshme të infeksionit Covid-19, çdo mjeku i kërkohet të raportojë të gjitha rastet, edhe nëse ka vetëm dyshime, përmes një portali specifik të vënë në dispozicion nga ATS. Për të hyrë në portal, mjeku kompetent duhet të dërgojë një kërkesë në postën elektronike portalecovid@ats-milano.it dhe për dijeni në psa19@ats-milano.it.

TRAJTIMI I NJË RASTI TË KONFIRMUAR POZITIV ME COVID

Pas raportit pozitiv të konstatuar të rastit me Covid, ATS-ja njofton punëdhënësin dhe mjekun kompetent, anasjelltas nëse është Kompania e cila në dijeni së pari, e cila duhet të njoftojë ATS-në me postë elektronike te covid@ats-milano.it

ATS do të kërkojë nga mjeku kompetent listën e kontakteve të ngushta të identifikuar, në bashkëpunim me punëdhënësin, në bazë të një formati elektronik të saktë (lista e transmetuara me formate të tjera ose jo të plota nuk do të përpunohen); këto lista do të menaxhohen nga ATS-ja për të informuar mjekët për subjektet e karantinuar. ATS-ja do të japë udhëzime për mbikëqyrjen shëndetësore të kontakteve të ngushta që do të zbatohen në bashkëpunim me mjekun kompetent.

Kontaktet e ngushta janë persona që kanë pasur kontakt me rastin e konfirmuar me COVID19, që nga dy ditë para shfaqjes së simptomave derisa pacienti të izolohej. Në rastin e një personi që është gjithmonë asimptomatik, dritarja kohore për kërkimin e kontakteve shkon nga 48 orë para se tamponi të rezultojë pozitiv deri në izolim.

Përcaktimi i kontaktit të ngushtë

- ◊ një person që jeton në të njëjtën shtëpi me një rast COVID-19;
- ◊ një person i cili ka pasur kontakt fizik të drejtpërdrejtë me një rast COVID-19 (p.sh. shtrëngim duarsh);
- ◊ një person i cili ka pasur kontakt të drejtpërdrejtë të pambrojtur me sekrecione nga një rast COVID-19 (p.sh. prekje me duar të zhveshura e kartopcetave të përdorura);
- ◊ një person i cili ka pasur kontakt të drejtpërdrejtë (ballë për ballë) me një rast COVID-19, në distancë prej më pak se 2 metra dhe të paktën prej 15 minutash;
- ◊ një person i cili ka qenë në një ambient të mbyllur (p.sh. klasë, dhomë takimesh, dhomë pritje në spital) me një rast COVID-19 në mungesë të PMP-ve të përshtatshme;
- ◊ një punonjës shëndetësor ose një person tjetër që siguron ndihmë të drejtpërdrejtë për një rast COVID-19 ose personelin laboratorik të përfshirë në trajtimin e kampioneve të një rasti COVID-19 pa përdorimin e PMP-ve të rekomanduara ose përmes përdorimit të PMP-ve të papërshtatshme;
- ◊ një person i cili ka udhëtuar ulur në tren, aeroplan ose ndonjë mjet transporti tjetër ndërmjet dy vendeve në çdo drejtim në lidhje me një rast COVID-19; janë kontakte të ngushta edhe shoqëruesit e udhëtimit dhe personeli i caktuar në seksionin e avionit/trenit ku ishte ulur rasti në fjalë.



KRYERJA E TESTEVE SEROLOGJIKE TË ANTITRUPAVE DHE TESTEVE ANTIGJENIKE TË SHPEJTA

Testet serologjike janë shumë të rëndësishme në hulumtimin dhe vlerësimin epidemiologjik të qarkullimit viral. Testi serologjik është një mjet i rëndësishëm për vlerësimin e përhapjes së infeksionit në një komunitet, por nuk ka asnjë vlerë diagnostikuese. Serologjia mund të nxjerrë në pah ekspozimin ndaj virusit, por nuk është e mjaftueshme për të treguar një infeksion akut në zhvillim, për diagnozën e të cilit është e nevojshme të kryhet një tampon nazofaringeal;

Në lidhje me kryerjen e **testeve serologjike** te punonjësit, saktësohet se Rezoluta e Këshillit Rajonal të Lombardisë XI/3131 e datës 12 maj 2020 parashikon që kompanitë gjithashtu mund të përdorin testet serologjike jashtë mënyrës së përcaktuar nga Shërbimi Shëndetësor Rajonal, me kusht që të zbatohen udhëzimet e përbajtura në pjesën B të aneksit të rezolutës së dekretit.

Ndër udhëzimet, theksohet se:

- ◊ kompania duhet të njoftojë ATS-në, tek adresa e emailit psal19@ats-milano.it ose dipartimentoprevenzione@pec.ats-milano.it, synimin për të vazhduar me testin duke dhënë informacione dhe dokumente
- ◊ Laboratorët duhet të jenë të autorizuar dhe/ose të akredituar për ekzekutimin e testeve dhe që çdo test i shpejtë duhet të pasohet nga verifikimi me metodologjinë CLIA ose ELISA. Lista gjendet në lidhjen vijuese [lista e laboratorëve](#) (shikoni faqen në internet të rajonit të Lombardisë)
- ◊ Nëse testi është pozitiv, kontrolli i infektivitetit duhet të pasohet nga një tampon dhe në pritje të tamponit, duhet të aktivizohet mbikëqyrja e rastit të dyshuar dhe procedura e izolimit në mirëbesim.
- ◊ Rezultati pozitiv i testit serologjik i komunikohet ATS-së direkt nga laboratorit. Rezultati pozitiv i tamponit i komunikohet gjithashtu drejtpërdrejt ATS-së për marrjen përsipër të rastit.
- ◊ Tamponi duhet të kryhet në laboratorë të përfshirë në rrjetin e laboratorëve të njohur nga Ministria e Shëndetësisë. Lista gjendet në lidhjen vijuese [lista e laboratorëve](#) (shikoni faqen në internet të rajonit të Lombardisë)
- ◊ I gjithë procesi i ekzaminimit duhet të jetë pranuar nga palët e përfshira: mjeku kompetent, përfaqësuesit e punonjësve dhe punëtorëve, si dhe natyra vullnetare e pjesëmarrjes në këtë proces duhet të jetë e qartë për të gjithë. Me të njëjtën procedurë është e mundur të programoni një mënyrë që përfshin vetëm tamponin ose testin antigjenik të shpejtë.

Në lidhje me kryerjen e tamponëve antigjenikë të shpejtë, specifikohet se Rezoluta e Këshillit Rajonal të Lombardisë 3777 e datës 3 nëntor 2020 dhe udhëzimet plotësuese, të Ministrisë së Shëndetësisë 705 të datës 8 janar 2021 dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëqenies së Rajonit të Lombardisë 3182 të datës 20 janar 2021, vendosi një proces procedural të ngjashëm.

Midis rregullave, duhet të theksohet se në rast të një tamponi pozitiv gjatë ekzaminimit, në rastet e parashikuara në udhëzimet e lartpërmendura nga Ministria dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mirëqenies, është e domosdoshme që rezultati të konfirmohet nga një tampon molekular ose tampon antigjenik i gjeneratës së tretë.

Të gjitha informacionet dhe rregullat për dorëzimin e aplikimit mund të gjenden në faqen e internetit të ATS-së, në lidhjen e mëposhtme: <https://www.ats-milano.it/Portale/Notizie/novusact/viewarticle/articleid/3453>

KTHIMI NË PUNË

- ◇ Mbi bazën e dispozitave të fundit ministrore, punëtori që doli pozitiv mund të kthehet në punë pas rezultati negativ të një tamponi të vetëm të kryer jo më herët se 10 ditë nga rezultati pozitiv, me kusht që të paktën të kenë kaluar 3 ditë pa simptoma për personat që kanë pasur simptoma. Për punëtorët që rezultojnë pozitivë dhe qëndrojnë pozitivë me afat të gjatë, kthimi në punë mund të bëhet pas 21 ditësh nga testimi pozitiv i parë, për sa kohë që të kenë kaluar të paktën 7 ditë pa simptoma për personat që kanë pasur simptoma, madje edhe në mungesë të testimit negativ. NB: mungesa e shijes dhe mungesa e nuhatjes nuk merren parasysh në vlerësimin e simptomave.
- ◇ Sidoqoftë, duke theksuar ndryshimin ndërmjet dispozitave në fuqi, pasi edhe Dekreti Ministror i fundit i datës 14 janar 2021 ende i referohet protokollit të përbashkët të datës 24 prill 2020, punëtori mund të kontaktojë mjekun e tij të familjes dhe të kërkojë kryerjen e një tamponi shërimi edhe pas ditës njëzet e një. INPS udhëzon që të zgjatet izolimi derisa tamponi të ketë rezultat negativ, dhe sëmundja të vazhdojë të kurohet nën kujdesin e mjekut të familjes. Në mënyrë që të kthehet në punë, punëtori mund të kërkojë certifikim që tamponi ka rezultat negativ duke dërguar një email me të gjitha të dhënat e nevojshme të identifikimit në postën elektronike dip19@ats-milano.it.
- ◇ Kontaktet e ngushta të rasti të konfirmuar duhet të qëndrojnë të karantinuar në shtëpi, duke kufizuar sa më shumë kontaktet me bashkëjetuesit e tyre. Nëse nuk shfaqen simptoma, kthimi në punë bëhet pas 14 ditësh nga data e kontaktit të fundit, madje edhe në mungesë të një tamponi ose, përndryshe, pas një rezultati negativ të një tamponi të kryer jo më herët se dita e 10-të nga kontakti i fundit me rastin. Nuk parashikohet asnjë certifikim i mëtejshëm.
- ◇ Punëdhënësi nuk mund të kërkojë certifikim ose test tjetër - tampon ose test serologjik - për kthimin në punë të punonjësve dhe bashkëpunëtorëve të tij;
- ◇ Rastet e reja të dyshuara do të kryejnë tamponin diagnostikues: nëse rezultoni negativ subjekti kthehet për vlerësim klinik nga mjeku i familjes, nëse rezultoni pozitiv, bëhet një rast i konstatuar (shih pikën 1);

KOMUNIKIMET ME ATS

Tabela përmbledh kanalet e komunikimit me ATS Milano sipas subjektit

Subjekti	Posta ATS
Për të kërkuar qasje në portalin e raportimit të rasteve të dyshuara	portalecovid@ats-milano.it
Informacione për raste të konstatuara dhe mbikëqyrje të kontakteve	covid@ats-milano.it
Komunikimi për të filluar procesin e testimit serologjik	psa19@ats-milano.it dipartimentoprevenzione@pec.ats-milano.it
Komunikimi për të filluar procesin e ekzaminimit me tamponë antigjenikë të shpejtë	protocollogenerale@pec.ats-milano.it

FAKSIMILE DEKLARATË E RASTIT TË DYSHUAR QË DUHET TË VENDOSSET NË
LETREN E KOMPANISË

Ne deklarojmë se në datën

Z.

punonjës i kësaj kompanie ka temperaturë mbi 37,5° dhe/ose simptoma të infeksionit
Covid19.

Prandaj atij i kërkohet të shkojë në shtëpinë e tij dhe të kontaktojë menjëherë mjekun
e tij.

Nënshkrimi i punëtorit

Nënshkrimi i kompanisë

ESEM | CPT

ENTE UNIFICATO FORMAZIONE E SICUREZZA

Organismo Bilaterale Paritetico costituito da Assimpredil ANCE e Feneal UIL,
Filca CISL, Fillea CGIL per le province di Milano Lodi Monza e Brianza

Sistema Socio Sanitario



Regione
Lombardia

ATS Milano
Città Metropolitana